

**ILIRIAN MARTIRI****PROFESOR PAVLI HAXHILLAZI DHE STUDIMET E TIJ  
GJUHËSORE E KULTURORE PËR FJALËN SHQIPE**

1. Prof. em. dr. Pavli Haxhillazi, i lindur në Elbasan më 7 shkurt 1941, pasi kreu shkollën e mesme pedagogjike në atë qytet, ndoqi studimet universitare në Tiranë në degën e gjuhës shqipe dhe të letërsisë në Fakultetin e Historisë e të Filologjisë, ku u shqua për rezultate të larta. Menjëherë pas diplomimit, më 1962, u emërua si punonjës shkencor në Institutin e Historisë dhe të Gjuhësisë, aktualisht Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, ku zhvilloi një veprimtari të gjatë e të frytshme për 45 vjet me radhë në Sektorin e leksikologjisë e të leksikografisë në këtë institut, deri në daljen në pension në vitin 2008. Më 11.12.2016 u nda nga jeta pas një sëmundjeje të rëndë e të papritur.

Ndihmesa e rëndësishme e profesor Pavli Haxhillazit në fushën e leksikologjisë dhe të leksikografisë shqiptare theksohet në dëshminë thelbësore të veprimtarisë së tij si bashkautor në vëllimet I, II e III të “Fjalorit shumëvëllimësh të gjuhës shqipe”, që nisi të hartohet në vitet ’70 në Institutin e Gjuhësisë dhe të Letërsisë (dorëshkrimi ruhet në Arkivin e Institutit). Në vijim dëshmohet pjesëmarrja e tij si bashkautor në hartimin e “Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe” (1980) me 41.000 fjalë, si dhe të fjalorëve të tjerë që u punuan dhe u botuan kryesisht në bazë të këtij fjalori, në vitet 1984, 2002 e 2006.

Në kushtet e punës leksikografike në grup në këtë sektor, profesor Pavli Haxhillazi jo vetëm zgjeroi nëpërmjet studimit njohuritë shkencore në fushën e leksikologjisë. Mbi të gjitha, ai fitoi një përvojë të pasur që i mundësoi të përballej realisht dhe praktikisht me problemet që shtron trajtimi leksikografik i pasurisë leksikore krahinore të pabotuar dhe ishte gjithmonë i gatshëm të ndante me miqtë dhe kolegët çaste të paharruara të këtyre përvojave. Në këtë perspektivë integrohet dhe ndihet si themelvënës fakti që disertacioni i tij “Mbi disa veçori leksiko-semantike të “Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe” (1980)” (1985) vjen edhe sot te lexuesi i interesuar dhe i specializuar si fryt i përvojës së tij të pasur si leksikolog e leksikograf.

Kjo përvojë studimore shkencore gjendet e shprehur gjithashtu edhe në artikujt e botuar në revistat më autoritare në fushën e studimeve shkencore të gjuhës shqipe, si: *Vëzhgime mbi mbiemrat foljorë me prapashtesën -shëm në gjuhën shqipe* në “Studime filologjike”, 23(6)/1969, 2, f. 145-164; *Gjurmimi i fjalës shqipe në Kosovë e në viset me popullsi shqiptare në Maqedoni e Mal të*

Zi në “Gjuha jonë”, 4/1984, 1, f. 94-99; *Rreth karakteristikave stilistike të fjalëve në “Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe” (1980)* në “Studime filologjike”, 40(23)/1986, 3, f. 145-166; *Arritjet kryesore të leksikografisë shqiptare në fushën e hartimit të fjalorëve shpjegues të shqipes* në “Gjuha Shqipe dhe Letërsia në Shkollë”, 16, 1987, f. 139-148; *Mbi disa veçori leksiko-semantike të fjalëve në “Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe” (1980)* në “Studime filologjike”, 41(24)/1987, 1, f. 97-113; *Shënime stilistike në fjalorët shpjegues të shqipes* në “Gjuha jonë”, 7/1987, 4, f. 38-46; *Çështje të marrëdhënieve të leksikut të shqipes së sotme letrare me leksikun dialektor* në revistën “Studime filologjike”, nr. 44 (27)/1990, 2, f. 73-81; *Dallimet e fjalëve çekan dhe çekiç* në revistën “Gjuha jonë”, 11/1991, 2, f. 99-104; *Termet okielo dhe syth në shqipen e sotme* në “Gjuha jonë”, 12/1992, 3-4, f. 61-63; *Vepra themelore leksikografike për gjuhën shqipe dhe kulturën kombëtare shqiptare* në “Gjuha jonë”, 14/1994, 1-4, f. 74-81 dhe gjithashtu, me bashkautorët Tarik Llagami dhe Eqrem Shijaku, *Gjuha dhe norma letrare në shtyp dhe në RTV*, në “Seminari XVIII Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën shqiptare”, *Përmbledhje e ligjëratave, referimeve, kumtesave dhe e diskutimeve*. Tiranë, 19-31 gusht 1996, Akademia e Shkencave - Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë - Universiteti i Prishtinës - Fakulteti i Filologjisë, “Toena”, Tiranë, 1996, f. 289-296.

Nuk mund të lihet mënjanë fakti i vlerësimit të veprimtarisë studimore-shkencore e kulturore të studiuesve të tjerë të apasionuar të shqipes nga profesor Pavli Haxhillazi nëpërmjet recensioneve si: “*Fjalor i termave të topografisë ushtarake*”, Ministria e Mbrojtjes Popullore, Akademia Ushtarake, Tiranë, 1985, në revistën “Gjuha jonë”, 10/1990, 1, f. 86-89; “Jani Nushi, *Fjalë popullore nga Myzeqeja*”, Tiranë, 1991, 282 f., në “Gjuha jonë”, 12/1992, 1-2, f. 91-94; “Hasan Çipuri, *Terminologjia ushtarake e gjuhës shqipe*”, Shtëpia botuese e Ushtrisë, Tiranë, 1993, 225 f., në “Gjuha jonë”, 16/1996, 1-4, f. 116-121; “Abdullah Zymberi, *Leksiku bujqësor e blegtoral i të folmeve shqipe të Malit të Zi*”, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 1996, 293 f., në “Gjuha jonë”, 18/1998, 1-4, f. 139-143; “Qemal Murati, *Fjalor i shqipes truallsore të Maqedonisë*”, Shtëpia botuese “Album”, Tetovë, 1998, 221 f., në “Gjuha jonë”, 19/1999, 1-2, f. 115-119; “Një fjalor i hapur për gjuhën shqipe” (Mehmet Elezi, *Fjalor i gjuhës shqipe*, Enti botues “Gjergj Fishta”, Tiranë, 2006, 1668 f.), në “Gjuha jonë”, 24/2006, 3, f. 97-102; *Një fjalor gjithnjë i hapur për gjuhën shqipe*, në “Studime filologjike”, 61 (44)/2007, 3-4, f. 211-217; “Botimi i dorëshkrimit origjinal të veprës leksikografike trigjuhëshe italisht-greqisht-shqip të Thimi Mitkos”, në “Studime filologjike”, 67 (50)/2013, 1-2, f. 257-264.

Gjithmonë në kuadrin e veprimtarisë së tij komplekse në këtë fushë, nuk mund të lihen pa përmendur edhe faktet se profesor Pavli Haxhillazi ka marrë pjesë vijimisht në punën dhe në aksionet e Institutit për pasurimin e Kartotekës së Leksikut të Shqipes me vjelje leksikore nga letërsia e publicistika shqiptare e

të gjitha periudhave, si dhe me materiale të mbledhura në terren në krahina të ndryshme të Shqipërisë e të Kosovës.

Një fushë tjetër mjaft e rëndësishme e kësaj veprimtarie, të cilën ai e realizonte me një kompetencë, autoritet, humanizëm dhe natyrshmëri mbresëlënëse është edhe pjesëmarrja në veprimtaritë shkencore të Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë, si dhe në veprimtari shkencore të organizuara nga shoqatat shkencore të arsimtarëve në shumë rrethe të vendit, duke referuar për tema nga fusha e leksikologjisë dhe e kulturës së gjuhës. Për më tepër, në këtë perspektivë vlen të theksohet si një kulminacion edhe veprimtaria e këtij profesori në arsimin e lartë, si pedagog i jashtëm në Fakultetin e Historisë dhe të Filologjisë në Tiranë dhe në Universitetin “Aleksandër Xhuvani” në Elbasan.

Paralelisht me këto veprimtari, nga viti 1992 e deri më 2006 punoi si anëtar i redaksisë së revistës “Gjuha jonë”, që botonte Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, duke dhënë ndihmesën e tij për mbarëvajtjen e revistës, veçanërisht për rubrikat nga fushat e leksikologjisë dhe leksikografisë, për të cilat bashkëpunoi me mjaft mbledhës e studiues të fjalës shqipe nga treva të ndryshme të vendit tonë, si Elbasani, Gramshi, Librazhdi, Kruja, Kukësi, Shkodra, Tirana, Tropoja, por edhe nga Kosova e Mali i Zi, për të dhëna nga Lypjani, Shtimja, apo dhe nga Malësia e Gjakovës. Këtu spikat bashkëpunimi i tij me Sulejman B. Ahmetin, bashkëpunim i cili i dha frytet dhe u kurorëzua veçanërisht me një vepër të mirëfilltë e të plotë leksikografike, siç është *Fjalori i shqipes së Plavës dhe Gucisë*, me 206 f., botuar nga ShB “Toena” në Tiranë, viti 2004, pas botimeve të mëparshme të pjesëve të zgjedhura nga një korpus i tillë pikërisht në tre numra të revistës “Gjuha jonë” në vitet 2000-2001.

Përveç të gjitha këtyre, nuk mund të lihet në harresë fakti i spikatjes së vlerës së tij si redaktor shkencor i kujdesshëm i një numri veprash gjuhësore e kulturore të përgjithshme, tek të cilat dha ndihmesë të rëndësishme duke sjellë përmirësime të ndjeshme në nivelin shkencor të tyre. Mes shumë të tillave, këtu mund të përmendej *Bibliografi e leksikografisë shqipe* me bashkautorë Artan Goga dhe Flora Zeqja – në: “Leksikografia shqipe – trashëgimi dhe perspektivë” (Konferencë shkencore, Tiranë, 3 dhjetor 2004. Akademia e Shkencave e Shqipërisë. Tiranë, 2005, f. 329-371.

2. Në lidhje me vizionin e tij shkencor, ashtu siç vetë profesor Haxhillazi e paraqet në mënyrë të veçantë në artikujt e tij të botuar në revistën “Studime filologjike”, duhet theksuar vëmendja e tij tek ajo që është më e ngutshme dhe thelbësore, e lidhur ngushtë me faktorët që kushtëzojnë komunikimin në gjuhën shqipe, në përputhje me ligjësitë e vetë gjuhës njerëzore në tërësi, duke pasur parasysh këtu jo vetëm nevojat komunikative, por edhe faktin se diçka të tillë e kërkon mbi të gjitha specializimi dhe zhvillimi i mëtejshëm semantik, si dhe ngulitja përfundimtare tipësore e një kategorie të caktuar (në rastin konkret, ajo e mbiemrave me prapashtesën –*shëm*) në gjuhën letrare shqipe.

Këto parashtrime të çështjeve të vizionit shkencor të profesor Pavli Haxhillazit vihen në dukje duke pasur në konsideratë faktin e botimit në revistën prestigjioze “Studime filologjike” gjatë intervalit kohor 1969-1990 të katër artikujve të përmendur më sipër, të cilët merren në referencë në mënyrë të veçantë në këtë material studimor, për të pasur parasysh edhe kushtet metodologjike të studimit të gjuhës shqipe, në bazë të të cilave profesor Haxhillazi mori formimin shkencor më të mirë të mundshëm të kohës dhe e vuri në shërbim të shoqërisë shqiptare, si dhe të të gjithë të interesuarve për studimet e gjuhës shqipe në qarqet albanologjike ndërkombëtare.

3. Siç shprehet edhe vetë profesor Haxhillazi, denduria e përdorimit pasqyron në radhë të parë vlerën objektive shënuese të fjalës dhe nevojën për komunikim të klasave, të shtresave e të kategorive të ndryshme shoqërore. Në këtë perspektivë, kur sende e dukuri të caktuara janë të nevojshme për veprimtarinë kolektive, atëherë edhe fjalët që i shënojnë ato fitojnë përdorim të përgjithshëm dhe ngrihen në normë të përbashkët letrare kombëtare. Duke iu bashkuar atyre edhe fjalët e cilësuar stilistikisht, formohet tërësia e mjeteve leksikore që përdoren në ligjërime për nevojat shprehëse e komunikuese. Në lidhje me kategorizime të mëtejshme në studimet që janë kryer për leksikun, duke iu referuar kriterit të shkallës së zbatimit të normës letrare, profesor Haxhillazi thekson se është veçuar gjithashtu edhe leksiku karakteristik i ligjërimit të thjeshtë, leksiku dialektor-krahinor dhe leksiku argotik.

Për sa i takon çështjes së paraqitjes në fjalorët shpjegues të shënimeve të ndryshme stilistike, profesor Haxhillazi nuk lë pa përmendur faktin se vetë termi “shënime stilistike” përdoret në kuptimin më të gjerë, d.m.th. për fjalët që kanë kuptim të kufizuar në një variant ligjërimesor a stil funksional dhe në një sferë të caktuar. Në këtë kuadër, siç shprehet vetë ai, mbetet detyrë e leksikografisë sonë që në vepra të ardhshme leksikografike normative të forcohet vëmendja për sqarimet e ndryshme stilistike dhe për saktësimin e aparatit të shënimeve të posaçme për to.

Në një gjuhë letrare të lëvruar, së cilës i duhet të përmbushë nevojat shoqërore për komunikim edhe në sferat studimore, shkencore e profesionale, vendoset natyrshëm objektivi i realizimit të trajtesave rigorozë që kanë të bëjnë me çështjet e sistemit terminologjik. Kështu, në parashtrimet e tij, vetë profesor Haxhillazi i përmbahet postulatit themelor sipas të cilit kërkesa më e parë ndaj një termi në shkencë është që ai të ketë një përmbajtje të përcaktuar mirë dhe të jetë i njëkuptimshëm, pasi përndryshe lindin pëshqjellime. Ndërsa nga perspektiva e stilistikës gjuhësore, duke marrë në shqyrtim çështje të stilit të veprimtarisë shkencore-teknike, ai vë në dukje se shtresat e fjalëve që përbëjnë terminologjinë e shkencës përkatëse janë jo vetëm tipike, por edhe të domosdoshme nga pikëpamja shprehëse e komunikuese.

4. Të lidhura ngushtë me çështjet e nevojave komunikative në shoqëri janë edhe raportet e leksikut me dialektet dhe nënkategorizimet e tyre, të

integruara në sistemin gjuhësor. Vetë profesori, jo vetëm në materialet studimore, por edhe në praktikën e jetës së përditshme gjatë misionit të tij si gjuhëtar leksikograf e veprimtar shoqëror, siç edhe e dëshmoi gjatë gjithë jetës së tij, iu përmbajt mendimit se leksiku i veçantë dialektor përfshin ato fjalë e shprehje që janë specifike për një dialekt, nëndialekt a të folme dhe jo çdo fjalë që përdoret në ligjërimin e tyre.

Këto fjalë shënojnë zakonisht sende e dukuri që nuk lidhen me veprimtarinë e përgjithshme shoqërore dhe prandaj ato kanë përhapje truallsore të kufizuar. Pra, këto fjalë nuk kanë përhapje të gjerë në truallin gjuhësor të shqipes dhe as përdorim të përgjithshëm në ligjërimet e saj. Rrjedhimisht, profesor Haxhillazi mbetet i mendimit se leksiku specifik dialektor, që shërben si mjet komunikimi vetëm për një kolektiv më të kufizuar njerëzish, të cilët jetojnë në një truall të caktuar, nuk përfshihet në gjuhën letrare.

Ndërkohë, vëren profesor Haxhillazi, ndryshe qëndron çështja me ato fjalë e grupe fjalësh të leksikut dialektor, që ende nuk kanë përhapje aq të gjerë dhe nuk janë pasqyruar as në veprat e shkruara për shkak të rrethanave historike të zhvillimit, por që duhet të përvetësohen prej gjuhës letrare, në mënyrë që ajo të përmbushë nevojat e përgjithshme shoqërore për mjete shënuese e shprehëse. Për këtë, vijon ai në studimin e tij, është e domosdoshme që në radhë të parë të dallohet *leksiku i përgjithshëm popullor* i gjuhës së sotme shqipe nga *leksiku i veçantë, karakteristik e specifik për ligjërimet dialektore*. Aq më tepër që në gjuhën e shkruar ende hasen edhe sot formime të tilla që semantikisht e ruajnë karakterin e tyre dialektor.

5. Duke u thelluar më tej në çështjet e përdorimit gjuhësor të lidhura me leksikun, profesor Pavli Haxhillazi thekson duke u pozicionuar veçanërisht në faktin se fjalët që përdoren vetëm në ligjërimin libror ose vetëm në ligjërimin bisedor, përbëjnë një grup pak a shumë të kufizuar, kurse pjesa tjetër e leksikut të gjuhës është më e madhe dhe shfrytëzohet si në ligjërimin bisedor, ashtu edhe në ligjërimin libror.

Gjithashtu, konstaton profesor Haxhillazi, në gjuhën e sotme letrare hyjnë mjaft fjalë që përdoren edhe vetëm në një dialekt a në të folme të veçanta të tij. Në këtë mënyrë, këto fjalë i kapërcejnë kufijtë e përdorimit të tyre të ngushtë dialektor. Por, që të hyjnë në leksikun e gjuhës letrare, fjalët dialektore duhet t'i kapërcejnë kufijtë e ngushtë dialektorë dhe të shtrihen e të fitojnë përdorim të përgjithshëm. Kështu, në leksikun e gjuhës letrare zënë vend ato fjalë me prejardhje prej dialekteve dhe të folmeve, të cilat shënojnë sende e dukuri që kanë rëndësi të veçantë për jetën e përgjithshme shoqërore dhe, për këtë arsye, kanë përdorim më të qëndrueshëm e përhapje më të gjerë.

Megjithatë, denduria e përdorimit herë-herë është një nocion relativ, që lidhet me faktorët jashtëgjuhësorë. Si e tillë, vë në dukje profesori në parashtrimin e tij, denduria e përdorimit, e bashkë me të edhe gjerësia e përhapjes së fjalëve, lidhen me veçoritë e realieve, si dhe me rëndësinë e

sendeve e të dukurive që shënojnë ato për gjithë veprimtarinë shoqërore. Sa më të rëndësishme të jenë sendet dhe dukuritë që shënojnë fjalët, aq më e gjerë është përhapja e tyre truallsore dhe aq më i dendur është përdorimi nga mbartësit e gjuhës.

Ndërsa në rastet kur leksiku dialektor dhe kuptimet dialektore të fjalëve të gjuhës letrare nuk e zgjerojnë përdorimin e tyre dhe nuk ngrihen në normën leksikore të shqipes së sotme letrare, atëherë ato mbeten përtej kufijve të saj. Sidoqoftë, profesor Pavli Haxhillazi i përmbahet mendimit se vetëm kur këto fjalë a kuptime fjalësh fitojnë përdorim të përgjithshëm a të qëndrueshëm në përbërjen e gjuhës letrare, pikërisht atëherë ato e humbasin karakterin e tyre të ngushtë dialektor dhe zënë vend në shtresat leksikore të gjuhës së sotme letrare.

Nisur edhe nga vëzhgimet e këtij profesori, rezulton një e vërtetë e pamohueshme fakti që një pjesë e mirë e fjalëve të përdorimit të përgjithshëm përdoren në të gjitha trajtat e ligjërimit, kurse ato që mbajnë “vulën“ e përdorimit në një ligjërimit të veçantë përbëjnë një sasi relativisht të vogël mjetesh leksikore. Kështu, jashtë studimit dhe klasifikimit do të mbetet pjesa kryesore e leksikut të përdorimit të përgjithshëm. Prapëseprapë, profesori thekson se shumica e fjalëve të leksikut të përbashkët janë të fondit themelor të gjuhës, janë fjalë të përdorimit të përditshëm dhe të përgjithshëm. Gjithashtu ato janë fjalë edhe me kuptime abstrakte, si dhe mjaft njësi frazeologjike që zakonisht janë përdorur në letërsinë politike-shoqërore, shkencore-teknike, artistike etj.

6. Në studimet e tij, profesor Pavli Haxhillazi vë në dukje se korpusi të cilit i referohet përbëhet nga fjalë me kuptime konkrete, që lidhen me natyrën dhe jetesën e popullit, me bujqësinë, blegtorinë dhe me fushat e tjera të veprimtarisë së shumanshme shoqërore. Gjithashtu, ai nuk lë pa përmendur faktin se gjatë hulumtimit të tij ka pasur të bënte me nocione e dukuri të së kaluarës historike, të cilat kanë luajtur rol në jetën dhe në historinë politike, shoqërore e kulturore të popullit tonë ose të popujve të tjerë. Aq më tepër që gjatë gjithë historisë së vet, populli shqiptar ka qenë në marrëdhënie ekonomike dhe kulturore me popuj të ndryshëm e me vende të tjera, të cilat janë pasqyruar edhe në ndikime të ndërsjella gjuhësore.

Në këtë perspektivë, profesor Haxhillazi thekson se zhvillimi i leksikut të shqipes letrare përcaktohet e kushtëzohet nga një varg faktorësh jashtëgjuhësorë, si ndryshimi i përbërjes shoqërore, zhvillimi i përgjithshëm i shkencës, i teknikës, i prodhimit, i kulturës materiale e shpirtërore etj. Për më tepër, vlerë të veçantë objektive merr përdorimi i fjalës nga autoritetet kulturore, politike, shkencore etj., në veprat e shkruara të letërsisë politiko-shoqërore, shkencore-teknike, artistike dhe të krijimtarisë gojore popullore, ku pasqyrohet edhe përdorimi i qëndrueshëm i këtyre fjalëve në gjuhën e sotme shqipe.

Në hulli të këtij arsyetimi, duke iu referuar posaçërisht “Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe” (1980), në studimin krahasues të këtij fjalori me dy fjalorë të tjerë të rëndësishëm pararendës shpjegues të shqipes (“Fjalori i gjuhës shqipe” i vitit 1954 dhe “Fjalori i gjuhës shqipe” nga Kostandin Kristoforidhi më 1904), të botuar, siç shihet, në harkun e atyre tetë dekadave të para të shekullit XX, vetë profesori pohon se Fjalori i 1980-s ka arritur të pasqyrojë drejt edhe atë zhvillim objektiv të leksikut, të frazeologjisë e të semantikës leksikore, që është kushtëzuar nga tërë zhvillimi i jetës së vendit e i shoqërisë shqiptare pas Luftës së Dytë Botërore.

Megjithatë, duke i pasur parasysh të vendosur në të njëjtin plan krahasimtar fjalorët e marrë në shqyrtim në studimin e tij, vetë profesor Haxhillazi shprehet se mbetet i ndërgjegjshëm që këta fjalorë janë vepra cilësisht të ndryshme të leksikografisë shqiptare, që pasqyrojnë si gjendjen e gjuhës letrare kombëtare, ashtu edhe shkallën e përpunimit e të njohjes shkencore të gjuhës shqipe në tri periudha të ndryshme kohore: Rilindja jonë Kombëtare, vitet e para pas Luftës së Dytë Botërore, vitet ‘80 të shekullit XX.

Natyrisht, nuk mund të lihet mënjanë edhe cilësimi i tij lidhur me faktin se, edhe pse këto vepra të leksikografisë sonë nuk kanë dalë në kohë shumë larg njëri-tjetrit, gjuha letrare kombëtare gjatë kësaj periudhe (pjesa e dytë e shek. XX) ka pasur zhvillim të paparë ndonjëherë në historinë e saj si nga ana sasiore, ashtu edhe nga ana cilësore.

7. Në studimet, por edhe në praktikën e tij shkencore, profesionale e jetësore në fushën e leksikologji-leksikografisë, profesor Pavli Haxhillazi i është përmbajtur me rigorozitet e natyrshmëri pikëpamjes së shprehur në mënyrë aksiomatike, sipas së cilës leksiku i përgjithshëm popullor i gjuhës shqipe përfshin në vetvete fjalët dhe shprehjet e të gjithë truallit gjuhësor të shqipes, që përdoren në të gjitha të folmet ose në shumicën e të folmeve të saj.

Ndërkohë, vijon ai, nga ana tjetër, ngjyrimet subjektive që shprehin raportet e folësit me objektin e ligjërimit janë bërë veçori karakteristike për variantet e ndryshme ligjërimore dhe stilet funksionale të shqipes së sotme letrare. Kështu, krahas leksikut të pacilësuar stilistikisht, si elemente konstitutive të këtyre stileve janë edhe fjalët e cilësuar stilistikisht, të cilat shpesh përbëjnë shtresa të tëra e grupe që janë tipike për variantet ligjërimore dhe stilet funksionale të gjuhës së sotme letrare.

Gjithashtu, për sa i takon leksikut që përdoret në ligjërimin e letërsisë artistike, ai nuk përfshihet në të gjithë tërësinë e vet në kuadrin e gjuhës letrare. Duke iu referuar edhe sintezës nga studimet gjuhësore ndërkombëtare në këtë fushë, profesor Pavli Haxhillazi vë në dukje se ligjërimi i letërsisë artistike “përfshin edhe mjaft mjete nga sferat që nuk janë drejtpërdrejt objekt i normëzimit, madje edhe nga thjeshtligjërimi”. Rrjedhimisht, duke pasur këtë shkallë diferencimi stilistik, thekson profesori në studimin e tij, shqipja e sotme

letrare me mjetet e saj leksikore qëndron krahas gjuhëve të tjera kryesore indoevropiane, të cilat kanë një traditë më të gjatë lëvrimi.

8. Në paraqitjen e të dhënave shkencore në studimet e tij të botuara në “Studime filologjike” në vitet 1986, 1987, 1990, krahas interpretimit shkencor të dukurive gjuhësore në lidhjet e natyrshme mes tyre, siç e pohonte fuqishëm ai edhe në bisedat mes kolegësh e studentësh, një rëndësi të veçantë profesor Pavli Haxhillazi i kushtonte paraqitjes së të dhënave sipas metodës statistikore, të cilën e çmonte veçanërisht për aftësinë sintetizuese të paraqitjes së masës së shtrirjes dhe të përhapjes së dukurisë së marrë në shqyrtim, në relacionet e saj me dukuritë më të afërta, të paraqitura statistikisht në parametra studimore.

Ndërsa, për sa i takon studimit të tij mjaft të vlerësuar edhe nga rrethet ndërkombëtare të studimeve leksiko-semantike lidhur me mbiemrat me prapashtesën *-shëm* në gjuhën e sotme shqipe, të botuar në numrin 2 të revistës “Studime filologjike” të vitit 1969, pikësëpari ai paraqet një panoramë interesante të studimit të kësaj kategorie mbiemrash nga studiues të gjuhës shqipe nga vendi dhe nga bota, duke filluar që nga cilësimet më të para lidhur me një kategori të tillë, të dhëna nga Sami Frashëri në dy dekadat e fundit të shekullit XIX. Megjithatë, siç do të shprehej vetë profesori, këto vëzhgime mbeten të përgjithshme, sepse autorët nuk kanë pasur si qëllim në vetvete analizën e këtyre formimeve.

Gjithashtu, sërish duke iu referuar këtij studimi, siç shprehej dhe vetë ai në biseda të lira mes kolegësh, duke qenë i sintonizuar fuqishëm në linjën e një disipline rigoroze shkencore, vlen të përmendet rëndësia që profesor Haxhillazi i jepte mbështetjes në kriteret të qarta dhe objektive, të cilat, përveç të tjerave, kanë edhe karakter thjesht metodik për shqyrtimin e materialit (në rastin konkret, kur kuptimi i mbiemrit foljor është i varur nga kuptimi i foljes, kuptimi i së cilës ruhet në temën prodhuese të mbiemrit dhe lidhet me të). Duke pasur të qartë edhe radhën e dukurive të marra në shqyrtim, ja dhe një tjetër citim sipas fjalëve të tij: *Përpara se të kalojmë në analizën semantike të këtij grupi (...) duhet sqaruar kjo çështje themelore: Cila temë foljore përbën temën prodhuese të këtyre mbiemrave?*

Gjithmonë në kuadrin e çështjeve metodologjike të studimit të leksikut të shqipes në tërësinë e tij, duke pasur parasysh njëkohësisht vizionin që hapej para studiuesve, por edhe mundësitë e kufizuara për shkak të kohës, të kontributeve dhe të mjeteve modeste në dispozicion, profesor Pavli Haxhillazi vijimisht në artikuj e biseda i përmbahej kredos së tij, por edhe të çdo studiuesi tjetër të apasionuar, sipas së cilës njohja më e plotë dhe studimi i pasurisë leksikore të gjuhës sonë është detyrë shumë e rëndësishme e leksikologjisë dhe e leksikografisë në ditët e sotme dhe në të ardhmen. Në këtë kuadër, nëse fjala ka hyrë në veprat e shkruara të letërsisë politike-shoqërore, shkencore-teknike, publicistike, artistike etj., kjo është më e kapshme. Në këtë perspektivë, në etapën e lëvrimin të shqipes letrare, vetë ai ishte i vetëdijshëm lidhur me një

përqendrim më të fortë te problemi i pastrimit dhe i pasurimit të gjuhës letrare shqipe, krahas njohjes më të plotë të vlerave gjuhësore kombëtare.

Në këtë mënyrë kalohet rrjedhshëm edhe te fjalët dialektore. Pasi bën një panoramë parashtrimi të termave për dukuritë e kësaj natyre, vetë profesori ndalet në faktin sipas të cilit, termat që përdoren më shumë në gjuhësinë shqiptare në këtë fushë dhe që janë formuar pak a shumë në mënyrë të përgjithshme janë “dialektizëm” dhe “krahinorizëm”, për të vijuar më pas me preokupimin sfidues, që ka të bëjë me faktin se leksiku specifik dialektor deri më sot nuk është njohur tërësisht dhe as nuk është pasqyruar plotësisht nëpër botime të ndryshme dhe nëpër fjalorë. Megjithatë, lënda e mbledhur tregon se leksiku dialektor është shumë më i gjerë nga sa njihet deri sot. Në këto kushte, mbledhja e tij është detyrë e gjuhësisë shqiptare si për kohën e sotme, ashtu edhe për të ardhmen.

Një çështje tjetër që lidhet me kategorizimin tërësor të leksikut të gjuhës shqipe, tashmë edhe ky si një orientim kryesor, mbetet përcaktimi i “etiketës” stilistike të fjalëve, por duke u mbështetur te parimi semantiko-stilistik. Në këtë kuadër hapen dritare të reja edhe për çështjet e lidhura me kategorizimet në stilet e ndryshme gjuhësore, për të cilat nevojitet të kryhen vëzhgime të mëtejshme.

9. Në punimet e tij, profesor Haxhillazi i përmbahet vizionit se gjatë analizës së gjuhës shqipe, të gjuhës së sotme letrare apo të gjuhës së një vepre a të një autori të veçantë, është e nevojshme të karakterizohet përbërja e leksikut dhe ngjyrimet e ndryshme të fjalëve që luajnë rol përcaktues për dallimin e stileve gjuhësore. Kështu, një analizë e veçorive semantike, krahas asaj strukturore, është e domosdoshme për zbërthimin dhe shpjegimin e drejtë të kuptimeve përkatëse, në mënyrë që të dhëna të tilla t’i bëjnë më të sigurt përfundimet që nxirren, qoftë edhe për faktin se sa këto të dhëna arrijnë të tregojnë për një vepër të caktuar, të marrë në shqyrtim, se deri në çfarë mase është ndërtuar ajo me përpjesëtime shkencore në tërë vëllimin e saj.

Gjatë analizave dhe parashtrimeve në punimet e tij, profesor Pavli Haxhillazi paraqet qëndrim vlerësues për të dhënat shkencore të mbledhura prej studiuesve dhe dijetarëve të cilët janë marrë më përpara me çështjen që ka ai në shqyrtim. Më konkretisht, në studimin për mbiemrat me prapashtesën *-shëm* në gjuhën shqipe, ai shprehet se vëzhgimet e paraqitura për këtë kategori gjuhësore nga korifej të studimeve si Aleksandër Xhuvani dhe Eqrem Çabej, ruajnë karakterin e tyre përgjithësisht parashtrues (ekspozitiv) në pasqyrimin e disa përfundimeve të analizës strukturo-semantike të formimeve me këtë prapashtesë.

Në vijim të kësaj linje, gjatë analizës semantike të mbiemrave foljorë në *-shëm* profesori ndalet pikësisht te kuptimi i tyre, për të kaluar më pas edhe te diferencimet kuptimore. Kështu, analiza semantike e formimeve foljore mbiemërore në *-shëm* realizohet duke pasur si mbështetje kryesore kriterin

sipas të cilit kuptimi i mbiemrit foljor varet nga kuptimi i foljes, kuptimi i së cilës ruhet në temën prodhuese të mbiemrit dhe lidhet me të. E thënë ndryshe, nga pikëpamja semantike, mbiemri ka një lidhje të drejtpërdrejtë me kuptimin e foljes që shërben si temë prodhuese, pa lënë mënjane faktin se zberthimi i kuptimit të mbiemrit nuk është gjë tjetër veçse shpjegimi i tij në një fjalor shpjegues.

Në këtë mënyrë, kjo analizë e kuptimit të mbiemrit bëhet për të sqaruar konkretisht disa çështje të kuptimit të mbiemrave të këtij grupi, si dhe lidhjen semantike të tyre me kuptimin e foljes që shërben si temë prodhuese e mbiemrave. Aq më tepër që, për të përcaktuar kuptimin dhe nuancat kuptimore që ka mbiemri, bëhet një analizë konkrete e materialit gjuhësor, për çdo njësi leksikore, si brenda çerdhes së saj në sistemin e sotëm fjalëformues, ashtu edhe në lidhjet sistemore leksikore.

10. Për sa u takon çështjeve që lidhen me hulumtimet në fushën e leksikut të gjuhës shqipe, në studimet e tij profesor Haxhillazi i përmbahet mendimit se vetë përfytyrimi i qartë dhe përcaktimi i normës letrare të njësuar kërkon studim shkencor të vetë leksikut dhe njohjen e ligjeve të brendshme të zhvillimit objektiv të gjuhës. Gjithashtu, zgjidhja e kësaj detyre shkon krahas me studimin dhe me përpunimin më të gjerë e të thelluar të problemeve të shumta të stilistikës gjuhësore, të cilat i kërkon vetë zhvillimi i sotëm i gjuhës letrare shqipe.

Ndërkohë, mbetet thellësisht evident fakti se pasuria leksiko-frazeologjike e gjuhës shqipe është më e madhe se ajo që është grumbulluar deri më sot në Kartotekën e Leksikut të Shqipes dhe se ajo që është pasqyruar në letërsinë e shkruar (fjala *letërsi* këtu përdoret në kuptim të gjerë). Jo pa të drejtë ai thekson se prej thesarit leksikor popullor kanë dalë dhe pritet të dalin në dritë vlera të tjera të shumta nëpërmjet kërkimesh të mëtejshme e më të thelluara për fjalë të cilat, ose kanë ekzistuar që më parë në gjuhë, sidomos në shtresën e leksikut pasiv të saj, ose kanë lindur rishtaz në procesin e pasurimit të gjuhës letrare shqipe.

Në vijim të procesit hulumtues, profesor Pavli Haxhillazi i përmbahet linjës orientuese sipas së cilës përdorimi i qëndrueshëm i fjalës në burimet e shkruara të letërsisë politike-shoqërore e shkencore-teknike, të letërsisë artistike, në artikujt kryesorë të shtypit periodik e të përditshëm, në veprat e klasikëve vizionarë të mendimit, në tekstet themelore të shkollës etj., jep mundësi që të mos gjykohet në mënyrë subjektive për vlerën dhe vendin e një fjale në leksikon e gjuhës së sotme letrare shqipe.

11. Dihet se ndryshimet në përbërjen shoqërore sjellin edhe fjalë e kuptime të reja. Edhe zhvillimi i shkencës dhe i teknikës shoqërohet me pasurimin dhe përsosjen e sistemeve të terminologjisë shkencore e teknike. Rrjedhimisht, përvijimi dhe përsosja e sistemit stilistik janë të lidhura drejtpërdrejt me zhvillimin e përgjithshëm të gjuhës së sotme letrare shqipe. Në

këtë perspektivë, vëren profesor Haxhillazi, shtresa e grupe të caktuara leksikore janë tipike për variantet ligjërimore dhe për stilet funksionale të shqipes së sotme.

Për më tepër, letërsia politike-shoqërore, shkencore-teknike, artistike etj., thithin pa ndërprerje vlerat më të mira të leksikut që jeton në ligjërimet popullore, pavarësisht se nga cili dialekt, nëndialekt a e folme vjen ai. Në këtë mënyrë, edhe fjalët dhe njësitë frazeologjike që kanë shtrirje në të gjithë truallin gjuhësor të shqipes dhe përdoren në variante të shumta ligjërimore, përfshihen brenda kufijve të gjuhës letrare shqipe. Ato përmbushin nevojat kryesore shënuese e shprehëse të të gjithë shqiptarëve.

Siç dëshmohet edhe në përvojën ndërkombëtare të paraqitur në artikuj shkencorë, të cilëve u referohet profesor Pavli Haxhillazi, ka shumë sende lokale që për shkaqe të ndryshme futen në “emërtesën e sendeve të përgjithshme popullore dhe fjalët që i shënojnë ato e humbasin karakterin e tyre dialektor”.

Këto njësi, për të cilat nuk ka sinonime në gjuhën letrare, e kanë më të lehtë rrugën e letrarizimit të tyre, sepse gjuha letrare nuk ka njësi të tjera sinonimike për të shënuar nocionet e tyre, duke mos harruar gjithashtu se në rrafshin diakronik vërehen kuptime fillestare dhe të prejardhura, kurse në rrafshin sinkronik... variante semantike parësore dhe dytësore. Kështu, fjalët polisemantike në gjuhën e sotme letrare shqipe i kanë edhe më të mëdha mundësitë për kuptime të markuara.

12. Në shkallën e sotme të zhvillimit e të përsosjes së mjeteve leksikore dhe në përgjithësi të gjithë sistemit gjuhësor, shqipja e sotme letrare është zhvilluar e është përsosur edhe cilësisht, duke përmbushur të gjitha funksionet e saj si mjet shprehjeje dhe komunikimi në të gjitha sferat e ndryshme të veprimtarisë politike, shoqërore, ekonomike dhe kulturore. Në këtë mënyrë, vijon profesor Haxhillazi në konkluzionet e studimeve të tij, gjuha letrare e njësuar sipas një norme të përbashkët kombëtare është forma më e lartë e komunikimit dhe e përpunimit të saj, e cila ka funksione më të gjera e më të plota shoqërore.

Në kushtet e zhvillimit të shqipes letrare në dhjetëvjeçarët e fundit të shekullit XX, FGJSSH (1980) luan një rol shumë të rëndësishëm për ngulitjen e normës gjuhësore. Një hap të tillë cilësor të zhvillimit të strukturës leksikore dhe të gjithë sistemit të saj, gjuha e sotme shqipe e bëri gjatë shekullit të kaluar, duke qenë në gjendje edhe ditët e sotme të përmbushë kërkesat e të gjitha fushave të veprimtarisë shoqërore.

Por, siç vë në dukje me kujdes vetë profesor Pavli Haxhillazi, diçka e tillë realizohet duke qenë ajo një normë e hapur ndaj dinamikës gjuhësore shoqërore në tërësi, e integruar natyrshëm me këtë ligjësi, që ndërthet në vetvete mirëfilli faktorë ndryshimi e zhvillimi të cilët ndikojnë në gjuhë, duke bërë gjithashtu që edhe shqipja letrare, si varianti më i plotë i gjuhës së

përbashkët kombëtare, të përpunohet e të përsoset më tej në trajtën e saj të shkruar e të folur.

Megjithatë, në këtë kuadër dhe në çështjet e kultivimit të natyrshëm gjuhësor të individëve, vetë profesor Haxhillazi thekson se ligjërimet dhe stilet funksionale të gjuhës letrare kanë jo vetëm tipare të përbashkëta, por edhe tipare dalluese që luajnë rol karakterizues. Kështu, shënimet stilistike në FGJSSH (1980) shërbejnë për të karakterizuar atë pjesë të leksikut të gjuhës së sotme letrare, e cila, për shkaqe të ndryshme, ka përdorim të kufizuar në ligjërim.

Në këtë perspektivë, edhe fjalët polisemantike janë një fond i rëndësishëm mjetesh leksikore, që fitojnë ngjyrimet e veçanta dhe e thellojnë diferencimin stilistik në shqipen e sotme letrare, si për shembull në rastin e njërës prej studimeve të tij, kur ai i bën të ditur lexuesit të ketë parasysh se në vijim të atij punimi, por edhe të një zhvillimi semantik të një termi që ndeshet rëndom edhe në punime të mëvonshme të studiuesve të tjerë, fjala *veprim* përdoret në kuptimin më të gjerë për foljet që tregojnë një veprim, të qenë, të ndodhur etj.

13. Në mënyrë të përsëritur profesor Pavli Haxhillazi, duke iu referuar jo vetëm literaturës ndërkombëtare që ishte e mundur të zotërohej në vitet kur ai ushtroi veprimtarinë e tij, por edhe themelvënësve të studimeve të thelluara të gjuhës shqipe si edhe profesori dhe udhëheqësi i tij shkencor, Androkli Kostallari, thekson se njohja e ligjeve të brendshme të zhvillimit e të pasurimit të gjuhës në përgjithësi dhe të gjuhës letrare kombëtare në veçanti ka rëndësi teorike dhe praktike për njohjen e thellë të shqipes letrare “si një sistem tërësor variantesh funksionale mbidialektore në të gjitha sferat e veprimtarisë shoqërore”. Në këto kushte, “jo karakteri lokal i “realies”, por “karakterit lokal i përdorimit të një fjale” bën që fjala të mbetet në mikrosistemin e saj (dialekti a e folmja) dhe të mos kalojë në një sistem më të lartë e të përpunuar (gjuha letrare kombëtare).

Duke u përdorur në gjuhën e shkruar, këto fjalë dialektore përpunohen e lëmohen më tej si nga forma, ashtu edhe nga përmbajtja e tyre kuptimore. Ato dalin kështu në lidhje paradigmatiche e sintagmatike me leksema të ndryshme të gjuhës letrare. Fjalët me prejardhje nga ligjërimet popullore karakterizohen edhe nga begatia e kuptimeve dhe e ngjyimeve leksiko-semantike, stilistike dhe shprehëse-emocionale. Kur ato zënë vend në gjuhën letrare, zhvillojnë e pasurojnë stilet funksionale të saj me mjete leksikore. Madje profesor Pavli Haxhillazi shprehet optimist se thellimi i mëtejshëm i këtij zhvillimi cilësor të shqipes letrare edhe në rrafshin stilistik do të rritë shkallën e karakterit më të plotë e sistemor dhe qëndrueshmërinë e mjeteve shprehëse të saj.

Por fjalët e cilësuar stilistikisht në tërësi ose në të gjitha kuptimet e tyre, ashtu si edhe fjalët e pacilësuar stilistikisht, nuk dallohen thjesht e vetëm nga pasuria e kuptimeve dhe e ngjyimeve kuptimore të fjalëve. Mbi të gjitha,

profesori vë në dukje se kjo pasuri e leksikut tregon zhvillimin e mëtejshëm të gjuhës së sotme letrare dhe shkallën më të lartë të njohjes shkencore të saj si për sasinë e fjalëve, ashtu edhe për kuptimet dhe ngjyrimet e shumta kuptimore, stilistike e shprehëse-emocionale të tyre. Rrjedhimisht, në shqipen e sotme është përpunuar dhe formësuar një sistem i plotë stilistik, i cili përbëhet nga variantet ligjërimore dhe stilet funksionale.

Përpunimi i këtij sistemi është pasojë e zhvillimit të përgjithshëm e më të plotë të funksioneve shoqërore të gjuhës letrare shqipe, sidomos gjatë viteve 1946-1986, periudhë e marrë në shqyrtim prej tij në studimin e botuar në “Studime filologjike”, 2/1990, në faqen 74 të të cilit nuk ngurron të theksojë se grupi i fjalëve si ato të paraqitura në këtë faqe, me kuptimet ose ngjyrimet kuptimore, me ngarkesat stilistike dhe shprehëse-emocionale të tyre, plotëson sistemin leksikor të gjuhës letrare, e pasuron dhe e përsos më tej atë, duke zënë vend me këto vlera në shtresat e ndryshme të leksikut të shqipes së sotme letrare.

14. Kujt i drejtohet një punim i caktuar shkencor, qoftë ky në rastin e një fillese studimore me të dhëna vëzhgimesh të përgjithshme në një fushë të caktuar, apo edhe në rast të zgjerimit të spektrit studimor vijues po në të njëjtën fushë? Dhe vetë profesor Haxhillazi e thekson si vlerë paraprakisht imediate se, në kushte të tilla, vëzhgime të kësaj natyre mbeten të përgjithshme, pasi vetë tekstet kanë qenë të përcaktuara për nxënësit e shkollave, si dhe se vetë autorët kanë pasur si qëllim që vetë ato tekste të ishin të përcaktuara për një njohje të përgjithshme të veçorive gramatikore të gjuhës shqipe.

Në studimin e tij për tiparet semantike të mbiemrave me prapashtesën *-shëm* në shqipen e sotme, vetë ai vë në dukje se kjo kategori është specializuar kuptimisht në vijat e saj themelore, por brendapërbrenda del edhe me nuancimet e saj. Por, pikësëpari, kuptimi i këtyre mbiemrave foljorë është i varur nga kuptimi i foljes, kuptimi i së cilës ruhet në temën prodhuese të mbiemrit dhe lidhet me të. Kështu, nga pikëpamja e vlerës, tipari që shënon mbiemri mund të ketë lidhje vetëm me një kuptim të caktuar të foljes, e cila përbën temën prodhuese të tij dhe ky kuptim mund të jetë ose kuptimi kryesor i foljes, ose një kuptim i prejardhur a figurativ i saj.

Duke e ndarë në grupe këtë kategori mbiemrash, profesor Haxhillazi shprehet se mbiemrat e grupit të parë kanë nuanca kuptimore të ndryshme, të cilave u shtohen edhe nuanca të tjera kuptimore, si domosdoshmëria, pashmangshmëria dhe meritimi për t’iu nënshtruar një veprimi, ndërkohë që në grupin e dytë bëjnë pjesë ata mbiemra, të cilët nuk e kanë kuptimin e aftësisë dhe të mundësisë për kryerjen e veprimit a për t’iu nënshtruar një veprimi.

15. Duke e evokuar si një vlerë të mirëfilltë themelore intelektuale në dobi të dinamikës së jetës, profesor Haxhillazi thekson natyrshëm se njohja e ligjeve të brendshme të zhvillimit e të pasurimit të gjuhës në përgjithësi dhe të gjuhës letrare kombëtare në veçanti, ka rëndësi teorike dhe praktike, që ajo të

shërbejë aktivisht për forcimin e njësisë politike, ekonomike e kulturore të popullit shqiptar. Prandaj edhe parimeve e kritereve të mësipërme të klasifikimit të leksikut të gjuhës letrare shqipe, ashtu si edhe për gjuhët e tjera letrare, u shtohet parimi semantiko-stilistik, në bazë të të cilit fjalët shihen sipas vlerës së tyre shënuese dhe në lidhje të ngushtë me stilet e ndryshme të gjuhës letrare.

Por, para trajtimit të çështjeve që lidhen me diferencimet kuptimore që kanë ndodhur në gjuhën e sotme letrare shqipe, ndihet e nevojshme edhe një ndalesë tek ato fjalë a kuptime fjalësh që janë “asnjanëse” stilistikisht dhe “të përbashkëta” nga përdorimi për stilet dhe ligjërimet e ndryshme. Këtu shtrohet çështja për fjalët e pacilësuar (të pashenjuara a të pamarkuara) stilistikisht. Duke zotëruar të tilla cilësi, leksiku i pacilësuar stilistikisht nuk e ka të zhvilluar polisemantizmin, pasi nuk ka kuptime të prejardhura, të cilat rritin figurshmërinë dhe çojnë drejt markimit stilistik.

Rrjedhimisht, ky leksik përbën sfondin kryesor të mjeteve gjuhësore, në të cilin fjalët e tjera fitojnë ngjyrimet stilistike-funksionale dhe emocionale-vlerësuese. Siç vëren dhe profesor Pavli Haxhillazi në studimin e tij, duke qenë pjesa më e madhe e mjeteve leksikore, shtresa e fjalëve të pacilësuar stilistikisht përbën bazën kryesore të domosdoshme mbi të cilën pjesa tjetër e leksikut me ngjyrim stilistik dhe emocional-vlerësues merr vlerat karakterizuese për stilet e ndryshme të gjuhës letrare. Pikërisht për variantet e ndryshme të gjuhës së sotme letrare, ky leksik ka vlera të posaçme karakterizuese.

16. Në etapën e sotme të zhvillimit të përgjithshëm të shqipes, gjuha letrare ka arritje të shënueshme edhe në shtresimin stilistik dhe në përcaktimin e ngjyrimëve emocionale-vlerësuese të leksikut të saj. Njësitë gjuhësore, pra midis tyre edhe fjalët, kanë përmbajtje kuptimore të lëvizshme. Gjatë zhvillimit të gjuhës, fjalët ose e zgjerojnë këtë përmbajtje kuptimore ose e ngushtojnë. Sërish profesor Pavli Haxhillazi nuk ngurron t'i referohet në këtë fushë një baze themelore të vendosur nga titullari i tij, si dhe i kolegëve të tij, kur vë në dukje se një ndarje më të hollësishme të fjalëve nga ana semantike e ka bërë Androkli Kostallari në një kurs special leksionesh të mbajtur në vitin akademik 1960-1961 në Fakultetin e Historisë dhe të Filologjisë të Universitetit të Tiranës, të titulluar “Formimi i fjalëve në gjuhën shqipe”.

Kështu, ky zgjerim i përbërësve semantikë pasqyron edhe një zhvillim objektiv mjaft aktiv të përmbajtjes kuptimore të fjalëve në rrugën e polisemantizmit. Në këtë mënyrë pasurohet gjuha e sotme letrare me njësi leksiko-semantike, që kanë vlera shënuese e shprehëse, veçori stilistike dhe ngjyrimet emocionale. Arritjet teorike në gjuhësinë botërore e në gjuhësinë shqiptare, si edhe në stilistikën gjuhësore shqipe në veçanti, e bënë plotësisht të mundshëm vlerësimin e përgjithshëm stilistik të leksikut të gjuhës së sotme letrare shqipe, duke e pasqyruar atë madje dhe në vepra leksikografike

normative. Prandaj shqipja e sotme ka arritur atë shkallë zhvillimi, që e bën të qëndrojë krahas gjuhëve të tjera me lëvrim më të hershëm.

Gjithsesi, kujtimi i Profesor Emeritus Pavli Haxhillazit nuk harron t'u kumtojë brezave pasues të studiuesve se gjuha letrare shqipe ka edhe një shtresë fjalësh me ngjyrimë emocionale-vlerësuese, të cilat dallohen qartë nga shprehësia e tyre. Këto fjalë me ngjyrimë të tilla subjektive kanë fituar, krahas kuptimit të tyre nominativ, edhe ngjyrimë kuptimore karakterizuese-vlerësuese. Bashkë me to, ngjyrimet stilistike-funksionale dhe emocionale-vlerësuese të fjalëve lipset të njihen e të përcaktohen mirë për çdo gjuhë, si për fjalët vendëse të përdorimit të përgjithshëm, ashtu edhe për fjalët e huazuara, në emër të së ardhmes, në dobi të individit, të shoqërisë, të triumfit të vlerave dhe garantimit të dinjitetit të secilit.

## SUMMARY

### **PROFESSOR PAVLI HAXHILLAZI – AN IMPORTANT FIGURE IN ALBANOLOGICAL STUDIES**

The object of this article is the exposition of the original contribution of Prof. Em. Dr. Pavli Haxhillazi in Albanian linguistic studies, in the collection of the Albanian lexical treasure, in the writing of the Albanian language dictionaries, alongside many other scholars and lexicographers at the Institute of Linguistics and Literature from 1960 until 2010. His contribution on these fields is known by many specialists of Albanian language studies in Albania, Kosova and other countries interested in Albanian lexicography, lexicology and semantics. In addition, the purpose of this paper is a panoramic presentation of the vision and the values of Professor Pavli Haxhillazi for everyone interested in these fields. Prof. Haxhillazi will continue to be a great role model for future generations of scholars who remain open to new methodologies and perspectives.

